



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 59

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 16 janar 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq.

Munguan: Flora Brovina, Liburn Aliu.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i lartë i fushës për shëndetësi; Xheneta Sopjani-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 20.12.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit;
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2013;
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 20.12.2012

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës 20.12.2012.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit

Fikrim Damka- Tha se Raporti i punës për vitin 2012, është hartuar për aktivitetet e vitit 2012. Konsideroj që ka qenë një vit i suksesshëm, sepse kemi shqyrtuar dhe miratuar disa ligje. Kemi miratuar Ligjin e shëndetësisë. Duhet më seriozisht të bisedojmë për Ligjin për skemat pensionale. Kemi monitoruar vetëm një ligj. Sivjet duhet të monitorojmë më shumë ligje.

Time Kadriaj- Tha se Komisioni ka bërë një punë të mirë ekipore. Raporti është i hartuar mirë. Monitorimi ka ngecur paksa, sepse kemi pasur ardhje të një numri të madh të ligjeve nga fundi i vitit.

Salihe Mustafa- Tha se kemi punuar mirë si Komision. E kemi bërë vetëm një monitorim, sepse monitorimi i Ligjit të punës na ka marrë shumë kohë. Numri i vizitave në terren konsideroj se është më i madh, sesa ky që është i prezantuar.

Bahri Thaçi- Uroj që vendimet përsëri t'i marrim sa të jetë e mundur me konsensus, sepse çështjet që i kemi ne këtu prekin interesin e të gjithë qytetarëve. Nuk duhet të na ndodhin situata që vetë pozita të mos i përkrahë ligjet, të cilat i sjell në Kuvend.

Nazane Breca- Tha se si Komision kemi punuar mirë dhe nuk kemi manifestuar dallime në punën tonë. Në rend të parë e kemi pasur interesin e popullit.

Komisioni, njëzëri miratoi Raportin e punës për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2013

Fikrim Damka- Tha se ne e kemi marrë Strategjinë legislative të Qeverisë. Ne kemi edhe ligje të mbetura nga viti i kaluar. Ne duhet të marrim qëndrim për Ligjin e pensioneve. Konsultohuni me grupet e juaja parlamentare për këtë ligj, në mënyrë që mos të punojmë kot rreth këtij ligji.

Time Kadriaj- Tha se duhet të konsultohemi me grupet tona, në mënyrë që mos të humbim kohë kot, pra që rezultati të jetë zero.

Salihe Mustafa- Tha se kemi pasur dhe do të kemi edhe më tutje presione. I kemi pensionistët e Trepçës, të cilët kërkojnë një zgjidhje.

Fikrim Damka- Po ashtu, e kemi edhe Ligjin për odat dhe Ligjin për duhanin. E kemi edhe një kërkesë nga veterinarët, që edhe ata të kenë të drejtë për formuar një odë të veçantë për ta, në kuadër të këtij ligji.

Salihe Mustafa- Tha se për çështjen e veterinarëve duhet të konsultohemi dhe është mirë që t'i thërrasim veterinarët në një takim me ne.

Nazane Breca- Tha se nuk është e logjikshme që edhe veterinarët të futen në këtë ligj.

Bahri Thaçi- Ne duhet t'i dëgjojmë veterinarët dhe nuk duhet që t'ua mohojmë apriori të drejtën e tyre për t'u përfshirë në këtë ligj. Pra, duhet të konsultohemi rreth kësaj çështjeje.

Komisioni, njëzëri, miratoi Planin e punës së Komisionit për vitin 2013.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka